



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2786/prot.
1

07.04
Tiranë, më __. __. 2023

URDHËR

Nr. 264, Datë 07.04.2023

“PËR
MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË
NOTERES ALMA OSMANAJ”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar, Urdhrit nr.167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”,

KONSTATOJ:

Me Urdhrit nr. 424 datë 12.09.2022, të Ministrit të Drejtësisë, është vendosur pezullimi i përkohshëm i licencës së ushtrimit të profesionit noteris Alma Osmanaj, për periudhën kohore 1 (një) vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, për arsye shëndetësore.

Në këto kushte, lind nevoja për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, të noteris znj. Alma Osmanaj, me qëllim mbarëvajtjen e punës dhe mospengimin e shtetasve për pajisjen me akte noteriale të cilat ndodhen në arkivën e noterit, si dhe marrjen në dorëzim të vulës së thatë dhe të njomë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë përgjatë periudhës së pezullimit.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, në pikën 1 dhe 2 të Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe pas administrimit të emailit datë 31.03.2023, të Degës Vendore të Noterisë Tiranë,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të arkivës noteriale të noteris znj. Alma Osmanaj, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Znj. Stela Lamaj, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Znj. Erisa Sulçe, specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c.) Znj. Miranda Xhemalçe Osmani, përfaqësuese nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë.

2. Noteri, personi i autorizuar prej tij përmes prokurës së posaçme ose personi që ka në ruajtje arkivën i dorëzon regjistrat, aktet noteriale dhe vulat përkatëse Komisionit të ngritur në pikën 1 të këtij urdhri, në ditën dhe orën që është caktuar në marrjen e njoftimit përkatës.
3. Komisioni për marrjen në dorëzim të arkivës, merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe noteri, regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit dhe vulat përkatëse.
4. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, anëtarët e komisionit të caktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të verifikojnë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojnë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
5. Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterës të Degës Vendore të Noterisë Tiranë znj. Anisa Muskaj, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noterja plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryetjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
6. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noteriale noterës znj. Anisa Muskaj, si dhe marrjen në dorëzim të vulës së thatë dhe të njomë të noterit me qëllim ruajtjen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, përgjatë periudhës së pezullimit.
7. Ngarkohet Sektori Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personit përgjegjës, si dhe noterës Alma Osmanaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

